

NotatOnline

Version 1.0

MANUAL PËRDORIMI



Notat Online - Gjinnazi franko-shqiptar "Ernest Koliqi"

Programues/Dizenjues:

Gjergji Kokushta
IT/Mësues informatike
Gjinnazi franko-shqiptar
"ERNEST KOLIQI"

I. Çfarë është "NotatOnline"

"Notat Online" ju paraqet pasqyrën e notave që nxënësi i gjimnazit "Ernest Koliqi" është vlerësuar gjatë vitit shkollor. Kjo pasqyrë ka për qëllim të japë në mënyrë kronologjike ecurinë e nxënësit.

Për çdo lëndë nxënësi/prindi mund shohë vlerësimin me nota dhe notën e llogaritur me formulë:

$$\begin{aligned} & (0.4 \times \text{Mesataren e Notës me Gojë}) \\ + & (0.5 \times \text{Mesataren e Notës me Shkrim}) \\ + & (0.1 \times \text{Mesataren e Notës së Projektit}) \end{aligned}$$

II. Si të shohim pasqyrën e notave

Për të parë pasqyrën e notave mjafton të vizitoni faqen:

<http://www.ernestkoliqi.com/notat>

ose

vizitoni uebsajtin e shkollës: <http://www.ernestkoliqi.com>

Gjeni në krah të majtë menunë "**Nxënësit**" dhe vendosni mausin mbi ti; Klikoni mbi menunë "**Notat**" që shfaqet.



The screenshot shows a website interface. At the top, there is a banner with a photo of students and the text "Klikoni ketu per me teper info." and "Një gjimnaz për të rinjtë me një shkollë që na shpëton". Below the banner is a navigation menu on the left with the following items: "Nxënësit", "Faqja kryesore", "Njoftime", "Mbi shkollën", and "Foto galeri". The main content area on the right has a heading "Filozofia jonë" and a paragraph of text: "Të gjithë i njohim problemet e shkollës. Megjithatë funksionimi i një shkolle të por plotësisht i realizueshëm nëse pu dhe përkushtim. Prandaj në gjimnazin "Ernest Koliqi" ne udhëhiqemi nga 7". Below the text is a bullet point: "• Të gjithë nxënësit konsiderohen barabartë. Secilit nxënës i jepet individuale, por askush nuk priv notën që meriton".

Klikoni ketu per me teper info.

Një gjmnaz për të rinjtë me një shkollë që nxit pasionin

Nxënësit > **Notat**

Faqja kryesore

Njoftime

Mbi shkollën

Foto galeri

Filozofia jonë

Të gjithë i njohim problemet e shkollave. Megjithatë funksionimi i një shkolle të por plotësisht i realizueshëm nëse punojmë me përkushtim. Prandaj në gjmnazin "Ernest Koliqi" ne udhëhiqemi nga 7 p...

- Të gjithë nxënësit konsiderohen barabartë. Secilit nxënës i jepet individuale, por askush nuk privet nga notën që meriton.

Na shfaqet faqja e hyrjes "NotatOnline":

Notat Online - Gjmnazi franko-shqiptar "Ernest Koliqi"

[Ndihme](#)

Studenti / Prindi

Hyrje

Përdoruesi:

Fjalëkalimi:

Hyr!

Plotësoni fushat **Përdoruesi** dhe **Fjalëkalimi** me të dhënat tuaja. Shtypni tastin **Enter** ose klikoni butonin **"Hyr!"**.

Vini re: përdoruesi është i formës, gërma e pare e emrit dhe mbiemri. Psh: Nxënësi quhet Gjergji Kokushta, përdoruesi i tij do të jetë: **gkokushta**.

Fjalëkalimi është një kombinim gërmash dhe numrash:

a-z	A-Z	10-99	A-Z	a-z	10-99
-----	-----	-------	-----	-----	-------

 Shembull: **aA11Aa22** (8 karaktere)

III. Si të lexojmë pasqyrën e notave

Pasi keni hyrë në llogarinë tuaj, direkt ju shfaqet pasqyra e notave si dhe ndonje shënim apo koment nga mësuesit.

Shpjegim i pasqyrës

Pasqyra e notave			
Listimi i notave per nxenesin: XXXXXXXXXX			
	EMRI	(ATËSIA)	MBIEMRI
Anglisht 11 Nota e llog: 7.9 (8)	14/08/2012	04/09/2012	13/09/2012
	9	7	8
	G	SH	PR

Anglisht 11

emërtimi i lëndës

Nota e llog. 7.9 (8)

nota e llogaritur sipas formulës së mësipërme¹ dhe (nota përfundimtare)

G / SH / PR

G - notë me gojë; SH - notë me shkrim; PR - notë projekti

¹ Shiko kapitullin e I. Çfarë është NotatOnline.